

VENDIM
Nr. 461, datë 30.5.2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 4/2 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj” dhe të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në shkronjën “a” të pikës 1/3, emërtesa “Instituti i Trajnimit të Administratës Publike” zëvendësohet me “Shkolla Shqiptare e Administratës Publike”.

b) Në lidhjen nr. 6 që përmendet në pikën 10, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i) në kategorinë II-b shtohet emërtesa “Drejtor në drejtoritë e përmbajtjes në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike”;

ii) emërtesa “Menaxher trajnimi në Institutin e Trajnimit të Administratës Publike, në kategorinë III-a” zëvendësohet me “Menaxher trajnimi në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, në kategorinë III-b”.

2. Nëpunësit në pozicionet “Menaxher trajnimi të Institutit të Trajnimit të Administratës Publike”, të cilët emërohen në pozicione “Menaxher trajnimi në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike”, kompensohen me një shtesë page në atë masë që paga bruto e tyre të mos ulet në krahasim me nivelin e pagës që kishin para datës së miratimit të këtij vendimi, por jo më shumë se 1 (një) vit nga data e emërimit të tyre në këtë shkollë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga momenti i emërimit të nëpunësve në detyrë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha